



Datë: 08.05.2025
Numër Protokollit: 3141/2025

A.nr.494/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.494/2025, të datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesit M.B, A.GJ, F.Q, F.G, I.S, L.LL-K, M.J-K, R.B, Sh.T, A.K dhe S.M të cilët sipas autorizimit i përfaqëson M.B, kundër heshtjes admirativë ne lidhje me kërkesën e datës 06.12.2024 të drejtuar tek Drejtori i Përgjithshëm në Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “Kompensim Material”, në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ e filluar sipas ankesës me numër A.nr.494/2025, e datës 18.03.2025, të parashtruar nga ankuesit M.B, A.GJ, F.Q, F.G, I.S, L.LL-K, M.J-K, R.B, Sh.T, A.K dhe S.M të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesi M.B.

A r s y e t i m

Kandidati për praninë në shërbim civil, M.B, A.GJ, F.Q, F.G, I.S, Luljeta L.LL-K, M.J-K, R.B, Sh.T, A.K dhe S.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), më datë 22.04.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2618/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes admirativë ne lidhje me kërkesën e datës 06.12.2024 të drejtuar tek Drejtori i Përgjithshëm në Administratës Tatimore të Kosovës, për shkak të shkeljeve kushtetues dhe dispozitave ligjore në fuqi, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, vendosi për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.494/2025, të datës 18.03.2025 pasi që nga kërkesa përmes emali e datës 08.05.2025, rezulton se ankuesit nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë procedurë administrative.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.494/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar Ankuesit M.B;
- Organi të Punësimit; (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës); dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.